



RAPORTI TEKNIK **PROJEKT ZBATIM**

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT:

**“BLOKU QE KUFIZOHET NGA RRUGËT SHEFQET KUKA, RRUGA XHEMAL BRAJA, DHE
RRUGA SULEJMAN KALAJA”**

PËRGATITI: **“DAAM” SH.P.K & “NET-GROUP” SH.P.K**



Përfaqësuar nga: “DAAM” SH.P.K

KLIENT: **Bashkia Tiranë**
2024

PËRMBLEDHËSE

Permbledhese

1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM.....	3
1.1 Hyrje	3
1.2 Përshkrimi i gjendjes ekzistuese.....	3
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.....	15
2.1 Vendndodhja	15
2.2 Seksionet terthore tip	16
3. STUDIMI TOPOGRAFIK	23
3.1 Hyrje	23
3.2 Pasisjet dhe Instrumentat e perdorur	24
3.3 Rilevimi i Siperfaqes se matur	25
3.4 Përshkrimi i punes ne Terren	26
3.5 Përshkrimi fiziko-gjeografik i zones	26
4. PLANI I SHPRONESIMEVE	28
5. SQARIME.....	29
6. KONKLUZIONE.....	32

1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

1.1 Hyrje

Bashkia e Tiranës, kërkon të realizojë projektin e zbatimit (studim projektimin) për objektin: “Blloku qe kufizohet nga rrugët Shefqet Kuka, rruga Xhemal Braja, dhe Rruga Sulejman Kalaja”, Njësia administrative Nr.4 në qytetin e Tiranës.

Ky bllok ndodhet ne lindje te qytetit te Tiranes dhe kufizohet nga rrugët “Shefqet Kuka, rruga Xhemal Braja, dhe Rruga Sulejman Kalaja”.

Ndërhyrja në këtë zonë me përmirësim të infrastrukturës rrugore synon në një përfaqje të integruar të zhvillimit social, kulturor, ekonomik, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, si dhe mbrojtjes së ambjentit.

Kjo politikë ka për qëllim ofrimin me cilësi, sipas standardeve bashkëkohore të shërbimeve publike në të gjithë territorin, përmirësimin e cilësisë së shërbimit me ujë, infrastrukturës së kanalizimeve të ujrave të shiut, shërbimit të mbledhjes së mbetjeve urbane dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Sa me lart, referuar detyres se projektimit dhe qellimit qe kerkon te arrije, infrastruktura brenda ketij blloku do te kene elementet te cilet do te pershkruhen me poshte ne kete raport.

1.2 Përshkrimi i gjendjes ekzistuese

Objekti “Blloku qe kufizohet nga rrugët Shefqet Kuka, rruga Xhemal Braja, dhe Rruga Sulejman Kalaja”, shtrihet ne pjesen lindore te qytetit te Tiranës, me nje largesi prej rreth 3.62 km lineare nga qendra e qytetit Tirane.


Rruget e bllokut kanë një gjatësi rreth 1500 m dhe një gjërësi variabël 2-2. m, disa nga segmentet kryesore janë: “Sulejman Kalaja”, “Koco Miho”, “Meco Muro”, “Xhemal Broja”, “Koste Cekrezi” etj.



HOROGRAFIA

**Rrugët e zonës kryesisht kanë mungesë të infrastrukturës bashke me elementet e saj.
Me poshte jepet nje pershkrim me i detajuar per secilin segment:**

1. Rruga “Sulejman Kalaja”




HOROGRAFIA

Ky segment ka nje gjatesi prej 211 ml. Gjeresia e rruges varjon nga 4 m asfalt, trotuare qe variojne nga 0.5m – 1m, dhe kufizohet nga te dyja anet me rrethime me mur. Shtresa e asfaltit eshte e demtuar duke krijuar gropa ne rruge te cilat e bejne te veshtire kalimin e mjeteve sidomos ne kohe me shi.

- Shume nga pusetat ekzistuese jane te demtuara apo te bllokuara.
- Ndricimi ekzistonte me shtylla metalike.
- Kishte linje ujesjellesi dhe linje te ujerave te zeza.
- Mungonin hapesirat e gjelberta.
- Nuk kishte parking dhe as pika VGM.

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE



2. Rruga “Koste Cekrezi”



HOROGRAFIA

Ky segment ka nje gjatesi prej 222 ml. Gjeresia e rruges varion nga 3.5-5m dhe kufizohet nga te dyja anet e rrugeve me mure rrethuese. Rruga eshte e shtruar me pjeserisht me beton dhe pjeserisht me dhe.

-Gjate matjeve ne terren u vu re se ne nje pjese te rruges ekzistojne puseta te ujerave te ndotura si dhe disa puseta te pidentifikuara me kapak betoni. Por per gjendjen e tyre si dhe identifikimin do te kerkohet nje azhornim i linjave ne institucionet perkatese.

-Ndricimi ekzistonte dhe ishte i adaptuar ne shtyllat elektrike.

-Kishte linje ujesjellesi.

-Mungonin hapesirat e gjelberta dhe trotuaret per kalimin e kembesoreve.

- Nuk kishte parking dhe as pika VGM.

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE



3. Rruga “Xhemal Broja”



HOROGRAFIA

Ky segment ka nje gjatesi prej 325 ml. Gjeresia e rruges varjon nga 2m-4.5m dhe kufizohet nga te dyja anet e rrugeve me mure rrethuese. Rruga eshte e shtruar pjeserisht me beton dhe pjeserisht me dhe.

-Gjate matjeve ne terren u vu re se ne nje pjese te rruges ekzistojne puseta te ujerave te ndotura. Por per gjendjen e tyre si dhe identifikimin do te kerkohet nje azhornim i linjave ne institucionet perkatese.

-Ndricimi ekzistonte pjeserisht dhe ishte i adaptuar ne shtyllat elektrike/tensioni.


-Kishte linje ujesjellesi.

-Mungonin hapesirat e gjelberta dhe trotuaret per kalimin e kembesoreve.

- Nuk kishte parking dhe as pika VGM.

- Linje interneti kishte.

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE



4. Rruga “Meco Murra”



HOROGRAFIA

Ky segment ka nje gjatesi prej 262ml. Gjeresia e rruges ekzistuese eshte rreth 0.8m-4.5m dhe kufizohet nga te dyja anet e rrugeve me mure rrethuese. Rruga eshte e shtruar pjeserisht me cakell dhe pjeserisht me beton.

-Gjate matjeve ne terren u vu re se ne aks te rruges ekzistojne puseta te ujerave te ndotura si dhe disa puseta me kapak betoni te pidentifikuara. Per gjendjen e tyre si dhe per funksionalitetin do te kerkohet nje azhornim i linjave ne institucionet perkatese.

-Pusetat KUSH mungonin

-Ndricimi ekzistonte dhe ishte i adaptuar ne shtyllat elektrike/tensioni.


-Kishte linje ujesjellesi.

-Mungonin hapesirat e gjelberta dhe trotualet per kalimin e kembesoreve.

- Nuk kishte parking dhe as pika VGM.

- Linja e internetit ekzistonte me ane te shtyllave ajrore.

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE



5. Rruga “Koco Miho”



HOROGRAFIA

Ky segment ka nje gjatesi prej 280ml. Gjeresia e rruges ekzistuese eshte rreth 3.5m-6.0m dhe kufizohet nga te dyja anet e rrugeve me mure rrethuese. Rruga eshte e shtruar me dhe.

- Pusetat KUSH mungonin.
- Ndricimi ekzistonte dhe ishte i adaptuar ne shtyllat elektrike/tensioni.
- Kishte linje ujesjellesi.
- Mungonin hapesirat e gjelberta dhe trotualet per kalimin e kembesoreve.
- Nuk kishte parking dhe as pika VGM.
- Linja e internetit ekzistonte me ane te shtyllave ajrore

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE




2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Realizimi i këtij projekti do të bëhet mbi bazën e standarteve dhe kushteve teknike CNR dhe ato Shqipëtare, si dhe të konsultuara me normat e vendeve të tjera. Projekt ideja paraprake për objektin: “BLLOKU QE KUFIZOHET NGA RRUGËT SHEFQET KUKA, RRUGA XHEMAL BRAJA, DHE RRUGA SULEJMAN KALAJA”, është përgatitur në përputhje me Detyrën e Projektimit dhe rekomandimeve të dhënë nga Bashkia Tiranë.

2.1 Vendndodhja

Një paraqitje e përgjithshme e pozicionit gjeografik të objektit : “BLLOKU QE KUFIZOHET NGA RRUGËT SHEFQET KUKA, RRUGA XHEMAL BRAJA, DHE RRUGA SULEJMAN KALAJA”, jepet në vizatimin planimetrik mbi ortofoto marre nga ASIG si më poshtë:



Projekt ideja e projektuar nga ana jonë dhe e koordinuar me Bashkinë Tiranë është në përputhje me gjendjen aktuale dhe kërkesat e zonës për urbanizimin dhe zhvillimin e saj. Më poshtë jepet përshkrimi i projekt-zbatimit të përgatitur për objektin “BLLOKU QE KUFIZOHET NGA RRUGËT SHEFQET KUKA, RRUGA XHEMAL BRAJA, DHE RRUGA SULEJMAN KALAJA”. Rrugët janë projektuar duke marrë në konsideratë kryesisht parametrat gjeometrikë ekzistues të zonës në studim, si dhe kufizimeve të tjera në zonë (objekte, shtylla, etj). Është parashikuar ndërtimi dhe rikonstruksioni i plotë i rrjetit rrugor, ndërtimi i trotuareve nga te dy krahet e rruges, ose ne njerin nga krahet e rruges, ndërtimi i kanalizimeve te ujrave të shiut, ndërtimi i kalalizimeve te ujrave te ndotura, ndërtimi i ndriçimit rrugor dhe linjave rezervë.

Rrjeti rrugor është projektuar sipas kërkesave të Detyrës së Projektimit. Sensi i lëvizjes është bërë pjesërisht ne disa akese me 2 sense lëvizjesh, dhe pjesërisht ne disa akse me nje sens levizjeje.

Infrastruktura rrugore brenda objektit: “BLLOKU QE KUFIZOHET NGA RRUGËT SHEFQET KUKA, RRUGA XHEMAL BRAJA, DHE RRUGA SULEJMAN KALAJA”. ka nje gjatesi prej rreth 1500 ml.

2.2 Seksionet terthore tip

- Shtresat Rrugore

Është vlerësuar dhe përcaktuar që shtresat rrugore të ndërtohen tërësisht të reja. Këtë e përforcon akoma më tepër edhe fakti që në trup të rrugës do kryhen një sërë gërmimesh për rrjetet nëntokësore inxhinierike, pra trupi aktual do dëmtohet akoma më tepër.

Nga vlerësimet e formacioneve gjeologjike të trupit të rrugëve dhe intensitetit të trafikut për rrugët që do të projektohen është përcaktuar dimensionimi i shtresave rrugore si më poshtë.

Llogaritja e shtresave rrugore është bërë me metodën CBR, sipas manualeve të AASHTO-s dhe “Pavement Design Catalogue 2001” duke konsideruar qe pesha ne aks do te jete 8 ton, si parameter fillestar.

Parametrat për segmentin rrugor në fjalë janë si më poshtë:

Dimensionimi i shtresave rrugore:

- Paketa e parashikuar e shtresave (ndërtim i ri):
 - Asfaltobeton + Emulsion Bituminoz (0.5 kg/m²) 4 cm
 - Binder + Emulsion Bituminos (1 kg/m²) 6 cm
 - Stabilizant (0-40 mm) 15 cm
 - Çakëll (0-60 mm) 30 cm
 - Gjeotekstil 280gr/m²
- Dimensionimi gjeometrik për rrugën:
 - Gjeresi variabel per akse te ndryshme;
 - Kuneta nga dy anët ne rruget me dy sense dhe nga njera ane ne rruget me nje sens, me gjerësi 0.5m;
 - Trotuare nga dy anet ne rruget me dy sense dhe nga dy anet ose njera ane ne rruget me nje sens me gjerësi 1 m;
 - Shpejtësia e projektuar është 20 km/h, ndërkohë që në afërsi të kryqëzimeve, kthesave, hyrje-daljeve shpejtësia do të jetë 20 km/h.

- **Bordurat dhe Kunetat**

Të gjitha segmentet rrugore do të kufizohen me bordurë betoni M-250 në krahun e rrugës dhe kur është e nevojshme edhe me bordurë fundore. Kunetat do të jenë me gjerësi 50cm dhe do jenë me beton C20/25 me trashësi mesatare 14 cm. Kuneta do realizohet me pjerrësi tërthore 8%. Në trup të saj do jenë të ndërtuara pusetat e shiut.

- **Trotuarët**

Në të gjithë rrugët, do të ndërtohen trotuare për kalimin e këmbësorëve. Trotuarët do të pozicionohen në të dy ose në njerin nga krahet e rrugës. Trotuarët do të jenë tërësisht të rinj me gjerësi 1m. Ato do shërbejnë për kalimin e këmbësorëve.

Shtresat e ndërtimit të trotuarëve do të jenë:

Shtresë pllaka betoni	6 cm
Granil	7 cm
Shtrese zhavorri	30 cm

Shtresat e trotuarit do të ndërtohen mbi trasenë e ndërtuar paraprakisht.

- **Plan-Organizimi i Punimeve të Ndërtimit**

-

Para fillimit të punimeve, nga ana e Kontraktorit të përzgjedhur do të paraqitet tek Mbikëqyrësi i objektit Plan-Organizimi për kantierin e ndërtimit. Plan-Organizimi i Punimeve të ndërtimit është i lidhur ngushtë me disponibilitetin e shoqërisë ndërtimore (Kontraktorit) në lidhje me makineritë, fuqinë punëtore, teknologjitë ndërtimore, etj. Gjatë përgatitjes së Plan-Organizimi të punimeve të ndërtimit të merren parasysh Specifikimet Teknike, Grafiku i Punimeve dhe udhëzimet e Projektuesit të dhëna në projekt.

- **Kanalizimet e Ujrave të Ndotura**

Përshkrimi i projektit të rrjetit të kanalizimit të ujrave të ndotura

Rrugët e projektuara në këtë bllok, përshkruajnë zonë me ndërtesa me funksionalitet të ndryshëm.


Sa më lart, është parashikuar në aks të rrugëve, të ndërtohet infrastrukture e kanalizimeve të ujrave të ndotura. Ky sistem do të përbëhet nga pusetat në cdo 25 m, me kapak gize, dhe me Tubacion PEHD të brinjëzuar DN 600 mm. Tubat do të vendosen mbi një shtresë rere 10cm dhe do mbulohen po më rere deri 10cm mbi kuroren e tubit.

- Kanalizimi i Ujrove te Shiut


Ne rruget e projektuara brenda ketij blloku do te ndertohet sistemi i kullimit te ujrave te shiut. Ai do te perbehet nga kunetat prej betoni C20/25. Kunetat do kene gjeresi 0.5m dhe pjerresi terthore 8%. Në çdo 25ml do ndertohen puseta shi mbledhese me zgara marmox (40x60cm). Kapaket do jane te prodhuar per ngarkesa deri ne 4 ton. Lidhja midis pusetave do behet me tuba PE të brinjëzuar (korrugato) me D=315mm te vendosura poshte kunetave. Tubat do te vendosen mbi njësjtrese rere 10cm dhe do mbuloohen po me rere deri 10cm mbi kuroren e tubit.

Seksionet tip te pershkruar me lart, do te kene paraqitjen grafike te meposhtme:

SEKSIONI TIP NR. 1




SEKSIONI TIP NR. 2




SHENIM: GJATE GJITHE TRUPIT TE RRUGES DO TE PERDORET GJEO TEKSTIL

SEKSIONI TIP NR. 3



SHENIM: GJATE GJITHE TRUPIT TE RRUGES DO TE PERDORET GJEO TEKSTIL

SEKSIONI TIP NR. 4



SHENIM: GJATE GJITHE TRUPIT TE RRUËS DO TE PERDORET GJEOTEKSTIL

- Sinjalistika Rrugore

Sinjalistika e rrugës në projekt përfshin sinjalistikën vertikale dhe horizontale. Për shkak të komunitetit dhe objekteve të cilat ndodhen përgjatë të 2 anëve të rrugëve, të cilat kërkojnë akses të vazhdueshëm, sistemi i qarkullimit të rrugëve do të trajtohet me dy ose me një sense lëvizjeje. Për të gjitha rrugët është hartuar një skemë e plotë qarkullimi.

Sinjalistika Horizontale është e përbërë nga:

- Vija gjatësore (vijëzimet do të bëhen me bojë bikomponente pastë sipas përshkrimit në preventiv, kjo për arsye të jetëgjatësisë sa më të madhe të sinjalistikës horizontale të rrugës);
- Vija tërthore;
- Vendkalime këmbësorësh;
- Shigjeta drejtuese;
- Shkrime dhe simbole;
- Në të gjithë rrugën do të bëhet vijëzimi. Vijëzimi përbehet nga vija të pandërprera dhe të ndërprera sic paraqitet në planimetrinë e sinjalistikës, me gjeresi 15 cm.
- Shigjetat e drejtimit të levizjes, të cilat do të vendosen në çdo korsi dhe para çdo kryqëzimi, për të bërë një orientim sa më të mirë të lëvizjes së mjeteve, sic paraqitet në planimetrinë e sinjalistikës;

Sinjalistika Vertikale do të përbëhet nga tabelat, të tipeve si më poshtë:

- Tabelat Detyruese;
- Tabelat Treguese;
- Tabelat Paralajmëruese.


Pozicionet dhe lloji i sinjalistikës horizontale dhe asaj vertikale janë të detajuara në planimetrinë përkatëse të sinjalistikës. Të gjitha tabelat do vendosen në ane të trotuarit dhe do të fiksohen me beton M-250.

- **Skema e levizjes**

Për të përcaktuar skemën e levizjes në objektin: “BLLOKU QË KUFIZOHET NGA RRUGËT SHEFQET KUKA, RRUGA XHEMAL BRAJA, DHE RRUGA SULEJMAN KALAJA”, u morën në shqyrtim elementet të cilët kanë rolin kryesor në qarkullimin e levizjes së mjeteve, në mënyrë që të arrihet skema më e pershtatshme dhe efektive e levizjes së mjeteve, e paraqitur në skemën e sinjalistikës, me shigjeta.

Shumica e rrugëve të prjektuara janë me një sens levizjeje. Rrugët të cilat janë me një sens levizjeje, është parashikuar që levizja të bëhet në sensin anti orar.

Me poshtë paraqitet skema e levizjes së automjeteve:



3. STUDIMI TOPOGRAFIK

3.1 Hyrje

Punimet gjeodezike per objektin: “BLLOKU QE KUFIZOHET NGA RRUGËT SHEFQET KUKA, RRUGA XHEMAL BRAJA, DHE RRUGA SULEJMAN KALAJA”, u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjithëshme dhe specifike te parashikuara nga Investitori. Firma projektuese organizoi punen dhe kreu punimet ne baze te pervojës se perfituar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese gjeodezike, GPS, TOTAL STATION DHE DRON”.

Rilevimi eshte bere duke perdorur bazat (antenat gjeodezike) qe ofron sistemi ALBCORS ne vendin tone (Sistemi Shqiptar i Pozicionimit Global), ky sherbim mundesohet nga ASIG (AUTORITETI SHTETEROR PER INFORMACIONIN GJEOHAPSINOR). Sistemi ALBCORS korrekton dhe gjeneron koordinata (X;Y) ne projektionin UTM dhe ellipsoid WGS84.


Kuotat absolute (Z) jane matur referuar Gjeoidit EGM96, te cilat tregojne lartesine mbi nivelin e detit.

Perdorimi i sistemit ALBCORS eshte nje lehtesi i cili ofron gjenerim te koordinatave gjeodezike ne cdo kohe dhe pozicion qe ndodhemi, keshtu qe mund te percaktohen lehtesisht koordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS.

Para fillimit te rilevimit u krye njohja e detajuar e terrenit, e cila sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes dhe organizimit te punes.

3.2 Pasisjet dhe Instrumentat e perdorur

Matjet u kryen me instrumentat gjeodezik si; GPS CHCNAV i90; FOIF TOTAL STATION RTS 362, GPS CHC/SINOV, SCANMASTER TOPCON GLS-1500, DRON DJI PHANTOM 4 RTK, te cilet teknikesht sigurojne matjet e kendeve e largesive, skanimin e fasadave ne 3D dhe detaje te tjera te nevojshme, me saktesine e kerkuar per projektimin e veprave infrastruktureore dhe civile.



TOTAL STATION FOIF RTS
362



GPS i90



GPS CHC SINOV M6



DRON DJI PHANTOM 4 RTK

3.3 Rilevimi i Siperfaqes se matur

Ne terren, u zhvillua fushata e matjeve te detajuara topografike deri ne ekstremet e zones/gjurmes qe do te zhvillohet, duke vazhduar dhe me infrastrukturen perimetrale qe e kufizon ate, (rruge, kanale, struktura,rrugica, mure, shtylla,etj). Ne realizimin e matjeve topografike jemi bazuar kryesisht ne zonat ku kane ndryshime te terrenit ekzistues, detajeve specifike si (rruge automobilistike, objekte, puseta ekzistuese te ujesjellesit, k.u.z, k.u.b, peme, shtylla elektrike/ndricimi, bordura, mure rrethues,porta hyrese,rruget lidhese, etj) kjo ne perputhje me kerkesat e pergjithshme dhe specifikimeve teknike te hartimit te projektit. Kjo u be e mundur ne bashkepunim me grupin studimor-projektues. Eshte rilevuar çdo detaj topografik ne te gjithë siperfaqen qe do te zhvillohet, si rruge te asfaltuara, bordura betoni, puseta metalike/betoni, shtylla elektrike/ndricimi, rruge sekondare, ndertesa,trotuare , mure rethues, portat hyrese,etj.

Elementet topografike te evidentuar ne terren jane hedhur ne planin e relievimit te pergjithshem. Punimet topogjeodezike te kryera jane mbeshtetur ne shkallen e plote te pergatitjes profesionale, ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik te te dhenave, per te plotesuar kerkesat teknike te parashtruara nga projektuesit. Çdo pike e marre ne terren ka koordinata tre dimensionale, te cilat jane te paraqitura ne planin e relievimit dhe ne fletet respektive te projektit.

Perpunimi i materialit topografik ne zyre eshte bere me programin AutoCad Civil 3D, nga ku eshte perftuar relievi i zones ne studim. Ky relief sherbeu per hartimin e projekt idese paraprake, me saktesine dhe cilesine e kerkuar ne termat e references nga investitori.

Ne materialin grafik te projektit jepet planimetria e relievimit, ku paraqiten edhe detajet e matura ne terren.

3.4 Pershkrimi i punes ne Terren

Per mbeshtetjen e punimeve fillimisht krijua lidhja me sistemin ALBCORS i cili nepermjet bazave te montuara ne te gjithë territorin tone ofron sinjal dhe korrektura brenda parametrave te lejuara ne cdo kohe, dhe mbi kete bazament u krye i gjithë rilevimi I zones, duke perdorur keto pika si stacione orientuese dhe referuese.

Rilevimi i zones ku do te shtrihet implementimi i projektit u realizua me metoden RTK. Prania e marresit baze ne largesi te kufizuar siguron saktesi me te larte te matjeve ne interval kohe me te shkurter. Element kryesor ne matjen RTK eshte mos humbja e lidhjes se fazes bartese gje e cila prish zgjidhjen perfundimtare. Kjo mund te realizohet duke shmatur futjen ne zona hije te sinjalit aty ku ka mbulesa poshte streheve te objekteve te larta ose zonave me reflektim te madh sinjali. Ne kete rast marresit GPS, japin nje sinjal i cili lajmeron matesin se duhet te rifilloje matjen nga nje pike e matur paraprakisht, duke siguruar saktesine e kerkuar. Ne zonat me pranine e ndertesave te larta, ku sinjali eshte i pa aksesueshem u perdor Stacioni Total Foif RTS 362". Po ashtu per matjen e objekteve dhe elementeve te tjere topografik te veshtire per tu aksesuar direkt u perdor Stacioni Total me lazer ne menyre qe te realizohej nje pozicionim sa me I sakate planimetrik I ketyre detajeve.

Per nje pasqyrim sa me te qarte te terrenit u perdor edhe droni DJI Phantom 4 RTK i cili shfrytezon gjithashtu antenat gjeodezike te sistemit ALBCORS.


3.5 Pershkrimi fiziko-gjeografik i zones

Zona ne studim eshte me nje relie v kodrinor. Kjo zone eshte nje zone kryesisht rezidenciale, ku ndodhen Pallate, objekte banimi private nje ose disa kateshe, objekte social – ekonomike, etj.

Ne kete zone ka te ndertuar rrjet ujesjellesi, ndersa rrjetet e tjera , kanalizime te ujerave te bardha dhe ujerave te ndodura kryesisht mungojne, rrjeti elektrik perbehet nga shtylla betoni disa prej te cilave kane te vendosura ne to edhe ndricim. Rrjeti i internetit eshte i vendosur ne shtylla druri.


Ne siperfaqen qe u rilevua ka sheshe rruge ekzistuese, mure rrethues, shtylla elektrike/ndricimi, objekte, ambiente rekreative etj.

Rilevimi Topgrafik



4. PLANI I SHPRONESIMEVE

Per arsye se rruget ekzistues kane gjeresi jo te mjaftueshme, madje disa rezultojne te jene 0.90m, pas projekt idese paraprake, rezulton te preken 15 objekte (shtesa, garazhe etj). Kjo edhe per arsye se shumica e rrugeve jane ne forme T-je dhe duhet te jene patjeter me dy sense levizjeje.



5. SQARIME

Ne mbledhjen e keshillit Teknik date: _____, ne bashkine Tirane, pas diskutimit te projekt idese paraprake,
u propozua qe ne kete bllok:

1. Te shtohet si pjese e projektit segmenti si me poshte paraqitur:



Ky segment lidh rrugen “Koco Miho” me rrugen “Shefqet Kuka”.

Per sa me siper pas fazes se project idese paraorake, u kryen matjet faktike ne terren dhe ky segment eshte trajtuar ne fazen e project idese perfundimtare.

2. Te studiohej mundesia per segmentin si me poshte paraqitur:



Per sa i perket ketij segmenti pas vizites ne terren u konstatua se:

- Shtrihet pjeserisht ne territorin e repartit ushtarak, i cili ishte i rrethuar me mur me gardh (si ne foto)



- Brenda rrethimit te repartit ushtarak po ndertohej nje objekt, dherat e te cilit ishin hedhur ne zonen ku u propozua te behej lidhja.



Per sa me siper, ky segment nuk mund te trajtohet me si mundesi per ta bere pjese te projektit.

6. KONKLUSIONE

Ndertimi i objektit “BLLOKU QE KUFIZOHET NGA RRUGËT SHEFQET KUKA, RRUGA XHEMAL BRAJA, DHE RRUGA SULEJMAN KALAJA”, paraqet mjaft interes në rritjen e mirëqënies së komunitetit.

Rrugët e projektuara ruajnë gjurmën e rrugës ekzistuese.

Trajtimi i këtyre rrugëve, me tërë elementet e infrastrukturës rrugore dhe të atyre inxhinierike, do të bëjë që ata të funksionojnë mirë në tërë drejtimet, duke i shërbyer komunitetit me tërë komponentet e nevojshëm jetësore. Rehabilitimi i tyre do të bëjë që cilësia e jetës në to të ndryshojë.

PËRGATITI: “DAAM” SH.P.K & “NET-GROUP” SH.P.K



Përfaqësuar nga: “DAAM” SH.P.K